



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



STATUTI I KOMUNËS SË KAMENICËS

KAMENICË, GUSHT 2008

Në bazë të nenit 12.2, 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 04 Qershor 2008) Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2008, miraton:

STATUTIN E KOMUNËS SË KAMENICËS

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Statuti i Komunës (në tekstin e mëtejme: Statuti) është akti më i lartë juridik, që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Statuti rregullon organizimin dhe funksionimin e brendshëm të komunës.

Neni 2

Komuna e Kamenicës (në tekstin e mëtejme: Komuna) është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, në kuadër të cilës qytetarët, drejtpërdrejt dhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur i realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre, në territorin e saj të përcaktuar me ligj.

Neni 3

Selia e Komunës është në Kamenicë, rruga "Skënderbeu".

Neni 4

Simbolet e Komunës

4.1 Komuna përdorë simbolet e veta: emblemën, vulat, stemën dhe flamurin e Komunës. Përmbajtja dhe përdorimi i simboleve, përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

4.2 Asnjë subjekt dhe person tjetër, përveç Komunës, nuk mund të përdorë simbolet e Komunës, pa autorizim paraprak, të dhënë nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi i Komunës).

4.3 Simbolet e Komunës miratohen dhe ndryshohen, nga Kuvendi i Komunës në pajtim me ligjet në fuqi dhe nuk duhet t'iu përngjajnë simboleve të komunave tjera në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.

4.4 Simbolet e Komunës mund të miratohen, apo ndryshohen me dy të tretat (2/3) e votimit të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

4.5 Kuvendi i Komunës, ndanë shpërblime, dekorata si dhe mirënjohje. Llojet e shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve, kushtet dhe mënyra e ndarjes së tyre përcaktohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 5

5.1 Komuna feston festat kombëtare, shtetërore dhe fetare, sipas Ligjit për Festat Zyrtare, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

5.2 Përveç festave të caktuara me paragrafin 1 të këtij neni, Komuna e Kamenicës feston edhe Ditën e Çlirimit të saj "18 Qershorin".

Neni 6

6.1 Komunikimi me organet e komunës dhe qytetarët, bëhet në gjuhën shqipe dhe serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës, shtypen në dy gjuhë; shqip dhe serbisht.

6.2 Kuvendi i Komunës miraton rregulloren Komunale të detajuar për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të saj, konform Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Neni 7

7.1 Komuna e ka statusin e personit juridik.

7.2 Komuna në mes tjerash, ka edhe këto kompetenca:

- a) Të paditë në gjykata
- b) Të posedoj, dhe të menaxhoj pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme.
- c) Mund të jetë pronare, apo bashkëpronare e ndonjë kompanie, që është në interes të komunës, në raport me qytetarët
- d) Të lidhë kontrata
- e) Të punësoj stafin e saj
- f) Të angazhohet, në aktivitete të tjera, që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së saj

Neni 8

8.1 Organet e Komunës, angazhohen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, statusin social, me qëllim që ata ti gëzojnë të drejtat me mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.

8.2 Përgjegjësitë e Komunës duhet të ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet, të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës, me Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 9

9.1 Statuti i Komunës zbatohet brenda kufijve të Komunës së Kamenicës.

9.2 Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saj te komunat tjera, apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera, në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.

Neni 10

Organet e komunës janë:

- a) Kuvendi i Komunës - organi më i lartë i Komunës dhe
- b) Kryetari i Komunës - organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Neni 11

Brenda territorit të saj Komuna ushtron përgjegjësitë, të cilat nuk i janë rezervuar shprehimisht me ligj institucioneve qendrore.

KOMPETENCAT E KOMUNËS

Neni 12

Komuna i ushtron kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin.

Neni 13

Kompetencat vetanake

Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- a) Zhvillimin lokal ekonomik
- b) Planifikimin urban dhe rural
- c) Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin
- d) Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit
- e) Mbrojtjen e mjedisit lokal
- f) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike si dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të ngrohjes lokale
- g) Përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale
- h) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagat, trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit
- i) Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut
- j) Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor
- k) Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi ndaj atyre që i'u cenohen të drejtat, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale
- l) Banimin publik
- m) Shëndetësinë publike
- n) Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë
- o) Emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- p) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike
- q) Turizmin
- r) Aktivitetet kulturore dhe të lira
- s) Çdo çështje, që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e saj, apo që nuk i është paracaktuar një autoriteti tjetër

Neni 14

Kompetencat e Deleguara

14.1 Komuna ushtron kompetencat e deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin, më sa vijon:

- a) Shënimet kadastrale
- b) Regjistrimin civil
- c) Regjistrimin e votuesve
- d) Regjistrimin e bizneseve dhe licencimin e tyre
- e) Distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve)
- f) Mbrojtjen e pyjeve, që ndodhen në territorin e Komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara, nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e druve, në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

14.2 Autoritetet qendrore në Kosovë, mund t'i delegoj kompetenca shtesë komunës, nëse është e nevojshme, në pajtim me ligjin.

14.3 Kompetencat e deleguara, në të gjitha rastet, duhet të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Kosovës.

KAPITULLI II

PROCEDURAT PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË STATUTIT TË KOMUNËS

Neni 15

15.1 Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Komunës mund të iniciohet nga:

- a) Kryetari i Komunës
- b) Një e treta (1/3) e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës dhe
- c) 15% e qytetarëve me të drejtë vote në komunë.

15.2 Propozimi për ndryshimin e Statutit Komunal duhet t'i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës para shqyrtimit final, duhet të konsultohet me publikun, në lidhje me atë propozim.

15.3 Pas përfundimit të periudhës së konsultimeve, Kuvendi duhet të vendosë, se a do ta miratoj Statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha vërejtjeve të dhëna nga publiku.

15.4 Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës, duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës, ashtu siç përcaktohet në nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

KAPITULLI III**FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE****Neni 16**

16.1 Komuna e Kamenicës përbëhet prej fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane sipas këtyre zonave kadastrave:

KODI KADASTRAL 10					
Nr.	Emri i vendbanimeve	Nr.	Emri i vendbanimeve	Nr.	Emri i vendbanimeve
1	Berivojcë	27	Kamenicë	53	Rajanoc
2	Bllatë	28	Karaçevë e Epërme	54	Ranillug
3	Bolec	29	Karaçevë e Poshtme	55	Ruboc
4	Bozhec	30	Korminjan i Epërm	56	Rogaçicë
5	Bratilloc	31	Korminjan i Poshtëm	57	Ropotovë e Madhe
6	Bushincë	32	Kolloleq	58	Ropotovë e Vogël
7	Busavatë	33	Kopërnice	59	Sedllar
8	Carec	34	Koretin	60	Strellicë
9	Çarakoc	35	Kostadincë	61	Strezoc
10	Dajkoc	36	Kranidell	62	Svircë
11	Dazhnicë	37	Kremenatë I	63	Shipashnicë e Epërme
12	Desivojcë	38	Kremenatë II	64	Shipashnicë e Poshtme
13	Domaroc	39	Krilevë	65	Shahiç
14	Drenoc	40	Lisockë	66	Topanicë
15	Feriqevë	41	Lajçiq	67	Tirincë
16	Glllogoc	42	Leshtar	68	Tomancë
17	Gmicë	43	Marocë	69	Tërstenë
18	Gogolloc	44	Meshinë	70	Tugjec
19	Gragjenik	45	Miganoc	71	Vaganesh
20	Grizimë	46	Moqar	72	Velegllavë e Epërme
21	Gjyrishec	47	Muçiverc	73	Velegllavë e Poshtme
22	Hajnoc	48	Novosellë	74	Vriçec
23	Boscë	49	Petroc	75	Zajçec
24	Hodonoc	50	Panqellë	76	Zhujë
25	Hodec	51	Poliqkë		
26	Hogosht	52	Rahovicë		

16.2 Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni të Statutit mbesin në kuadër të Komunës deri me zbatimin e procesit të decentralizimit konform Ligjit për Kufijtë Administrativ të komunave nr. 03/L-041

Neni 17

17.1 Për të siguruar plotësimin e të gjitha nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve, Komuna përmes Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës, vendosë të bëjë aranzhime me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të saj.

17.2 Kuvendi i Komunës përcakton aktivitetet, që mund t'i ushtrojnë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, e që janë në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të Komunës.

17.3 Kuvendi i Komunës për këto njësi siguron ndarjen e resurseve nga komuna, që janë në përpjesëtim me përgjegjësitë dhe aktivitetet e përcaktuara.

17.4 Kuvendi i Komunës, me akt të veçantë do të specifikoj zonat urbane dhe rurale duke i përfshirë edhe pjesët e atyre të organizuara në këshilla lokale.

Neni 18

18.1 Për shtrirjen edhe më tej të përgjegjësive të përcaktuara me ligj, komuna mund të krijojë zyre komunale informuese apo shërbyese për të ofruar shërbime më afër qytetarëve të saj.

18.2 Komuna mban kontroll të plotë për secilën fushë, që është në kompetencë të saj të dekoncentruar.

18.3 Zyret komunale që funksionojnë në kuadër të komunës janë:

- a) Zyra për shërbime të qytetarëve në Muçiverc
- b) Zyra për shërbime të qytetarëve në Hogosht

18.4 Zyret komunale do t'i kryejnë detyrat e përcaktuara me aktet nënligjore të Administratës Komunale.

Neni 19

Zyra komunale përbëhet nga pjesa administrative dhe duhet të drejtohet nga personeli i cili emërohet nga komuna. Për ushtrimin e detyrave të saj, zyra duhet t'i marrë fondet e nevojshme nga Komuna.

KAPITULLI IV

KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 20

20.1 Komuna duhet ta konsultoj publikun, në mënyrë që të sigurojë, se vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte, që janë marrë parasysht sugjerimet dhe përvojat e qytetarëve, që janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, si dhe të gjitha vendimet e propozuara mund të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë.

20.2 Komuna gjithashtu duhet të siguroj, që qytetarët kanë pasur mundësi, ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre janë marrë parasysh.

20.3 Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren Komunale, që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të Komunës, duke rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të Komunës.

Neni 21

Komuna mund të përdorë, secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë (si dhe format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):

- a) Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale
- b) Kontaktet me grupet e interesuara, për t'i testuar dhe diskutuar politikat;
- c) Anketat për implementimin e politikës, përveç tjerash informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo
- d) Shpalljet publike të propozimeve për politika apo projekt rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje në prezantime
- e) Kontaktet me grupet e interesit dhe mbledhjet me grupet e interesit;
- f) Tubimet publike
- g) Dëgjimet publike
- h) Studimet për vlerësim të efektit

Neni 22

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës, dhe komitetet e Kuvendit të Komunës duhet ta kenë autoritetin të mbajnë konsultime publike për çdo çështje, që janë në kompetencat e tyre.

Neni 23

Në secilin rast, duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila përdoret për mbajtjen e konsultave me publikun, duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur, për përgatitjen e prezantimeve. Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

Neni 24

24.1 Të gjitha komunikimet, në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta, dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme, për t'i lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje, prej dy faqesh më së shumti, të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre që do të jetë më lehtë për lexuesit, të përgjigjen, të kontaktojnë, apo të ankohen.

24.2 Kur përcaktohen grupet e interesuara në procesin e konsultimit, komuna duhet të siguroj, që palët relevante të kanë mundësi, t'i shprehin mendimet e tyre.

Neni 25

Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe duhet t'i adaptoj kanalet komunikuese, në mënyrë që të përmbushë synimet e audiencës. Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun, duhet të publikohen në faqen zyrtare të Komunës.

Neni 26

Komuna duhet të lejoj kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe sugjerimeve me shkrim. Komuna duhet t'i lejojë, së paku 8 javë për marrjen e përgjigjeve me shkrim, për konsultimin e publikut, ndërsa standardi duhet të jetë 12 javë.

Neni 27

Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në faqen zyrtare të komunës.

Neni 28

Kërkesat për Informim dhe Peticione

28.1 Çdo person, apo organizatë e interesuar, ka të drejtë të parashtoj kërkesë për informacion për veprimtarinë e komunës, ose t'i drejtoj peticion Kuvendit të Komunës, për çështjet që janë përgjegjësi e Komunës. Kërkesat ose peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës, brenda afatit të përcaktuar me ligj.

28.2 Pas shqyrtimit në Kuvend, Kryetari i Komunës, ose një zyrtar i autorizuar, jo më vonë se 30 ditë, nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.

28.3 Për çështjet, që Komuna nuk është kompetente brenda afatit të përcaktuar, në paragrafin 2 të këtij neni, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës, ose peticionit dhe e procedon te organi kompetent.

Neni 29

Iniciativa e qytetarëve

29.1 Qytetarët mund të marrin iniciativë, për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të Komunës, për miratim nga Kuvendi, apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.

29.2 Propozuesit ia dorëzojnë projekt rregulloren, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

29.3 Projekt rregullorja e propozuar, duhet të nënshkruhet, nga 15% e votuesve, të regjistruar, për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës.

29.4 Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Neni 30

Referendumi

30.1 Qytetarët mund të kërkojnë, që rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës ti nënshtrohen referendumit, në qoftë se një kërkesë e tillë, nënshkruhet nga 10% e votuesve, të regjistruar në komunë.

30.2 Për të gjitha çështjet tjera, që kanë të bëjnë me zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni do të aplikohen dispozitat e ligjit në fuqi.

Neni 31

Largimi i Kryetarit

31.1 Qytetarët e Komunës, mund të ndërmarrin iniciativë, për largimin e Kryetarit të Komunës.

31.2 Kërkesa e tillë, duhet të nënshkruhet, nga 20% e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i cili e paraqet çështjen, në institucionin përkatës, për administrimin e votimit.

31.3 Nëse shumica e votuesve të regjistruar, votojnë për largimin e Kryetarit, zgjedhjet e reja, për kryetar, duhet të bëhen, në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet.

KAPITULLI V

TUBIMET ME PUBLIKUN

Neni 32

32.1 Tubimet me publikun duhet të mbahen në një sallë, që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë, së paku dy tubime me publikun brenda vitit; një në gjashtë mujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.

32.2 Përveç kësaj, tubimet tjera me publikun, mund të mbahen, duke marrë parasysh, se duhet të ekzistoj një interval prej dy muaj, ndërmjet dy tubimeve.

Neni 33

33.1 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen së paku dy jave para mbajtjes së tubimit. Tubimet publike duhet të mos mbahen në datat, apo kohën që nuk është e përshtatshme, për pjesëmarrjen e komuniteteve të veçanta.

33.2 Përfaqësuesit e mediave, duhet të lejohen të marrin pjesë në të gjitha tubimet me publikun.

Neni 34

34.1 Kryetari i Komunës apo përfaqësuesit e tij/saj, duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin ta përcaktoj procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes, si dhe ka autoritetin të mos lejoj diskutimin për disa çështje të caktuara, që nuk janë të lidhura me çështjet e diskutuara apo që nuk janë në kuadër të pushtetit të komunës ose nuk kanë të bëjnë me punët e Komunës.

34.2 Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojnë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

Neni 35

Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

Neni 36

Procesverbali i secilit takim publik duhet të ruhet me të gjitha informatat e hollësishme, që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e publikut dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme duhet t'i bashkëngjitet procesverbalit të takimit.

Neni 37

Komiteti për politikë dhe financa duhet ta shqyrtoj procesverbalin e takimit publike brenda 60 ditësh. Komiteti duhet ta shqyrtoj secilin propozim të dhënë gjatë tubimit publik dhe pas kryerjes së konsultimeve të nevojshme të bëjë rekomandimet e duhura në takimin e ardhshëm të Kuvendit Komunal.

KAPITULLI VI

KOMITETET KONSULTATIVE

Neni 38

38.1 Kuvendi i Komunës formon komitetet konsultative, që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, Kuvendi i Komunës duhet të siguroj një përfaqësim të gjerë nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë; në formimin e këtyre komiteteve duhet të merret parasysh balanca gjinore dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese dhe/apo fshatrave brenda komunës.

38.2 Komitetet konsultative formohen nga Kuvendi i Komunës, pas propozimit të marrë nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme dhe nga grupi i qytetarëve.

38.3 Kuvendi i Komunës mund të formojë edhe komitete konsultative **ad hoc** për çështje të caktuara e që mandati i tyre pushon pas përfundimit të çështjes.

Neni 39

39.1 Komitetet Konsultative, duhet t'i paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve në Kuvendin e Komunës.

39.2 Komitetet Konsultative gjithashtu mund të bëjnë propozime për përmirësimin, apo zgjidhjen e problemeve të identifikuar.

39.3 Në kryerjen e detyrave të tyre, Komitetet konsultative duhet të punojnë së bashku, me Komitetet e Kuvendit në mënyrë të tillë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit të Komunës duhet të merren vetëm pas konsultimit me komitetin këshillëdhënës sektorial.

Neni 40

40.1 Komitetet konsultative përbëhen nga 5 deri në 9 anëtar.

40.2 Anëtarët e Komiteteve konsultative, duhet të emërohen me mandat 3 vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit. Asnjë anëtarë i Komitetit konsultativ, nuk mund të shërbejë më shumë, se në dy mandate të njëpasnjëshme.

KAPITULLI VII

KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI DHE ZËVENDËS KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 41

Kuvendi i Komunës

41.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë, këshilltarët e të cilit zgjedhen, në mënyrë të drejtpërdrejt, nga qytetarët, në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet Lokale.

41.2 Të gjithë qytetarët e Komunës, mund të kandidohen për këshilltarë në Kuvendin e Komunës, me kusht, që ata t'i plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin për Zgjedhjet Lokale.

41.3 Mandati i çdo këshilltari të Kuvendit të Komunës, verifikohet, nga Komisioni për verifikimin e mandateve, që themelohet, nga Kuvendi i Komunës, para nënshkrimit të mandatit, nga secili këshilltarë.

41.4 Të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës, duhet ta japin dhe nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

“Beto hem (ose deklaroj solemnisht), se do t'i kryej detyrat dhe autorizimet e mia, me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Kamenicës, në mënyrë, që të sigurohen, kushte për jetë të qetë, për të gjithë”.

41.5 Këshilltarët e Kuvendit të Komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin, ose mandatin në pajtim me paragrafet 3 dhe 4, të këtij neni, brenda një muaji, pas certifikimit të rezultateve, të zgjedhjeve, pushojnë, të jenë këshilltarë.

Neni 42

Deklarata Financiare

Në pajtim me nenin **38.3 të LVL**, çdo këshilltar i Kuvendit të Komunës, para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare dhe obligohen, të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare, posa ato të ndodhin, në regjistrin, që e mbanë Kryetari i Komunës.

Neni 43

Mbledhja Inauguruese

43.1 Kuvendi i Komunës e mban mbledhjen inauguruese, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

43.2 Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, thirret nga Kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

43.3 Nëse Kryetari i Komunës, nuk e thërret mbledhjen sipas obligimit në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës mund të thirret nga këshilltari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data kur Kryetari është dashur të thirr mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.

43.4 Nëse këshilltari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës mund të caktohet me iniciativë të shumicës së këshilltarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

43.5 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, që mbahen para zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës kryesohen nga këshilltari më i vjetër i Kuvendit të Komunës, që është i pranishëm në mbledhje.

Neni 44

Mandati

44.1 Mandati i këshilltarëve të Kuvendit të Komunës është katër vite.

44.2 Këshilltari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë këshilltar:

- a) Me rastin e përfundimit të mandatit të tij
- b) Nëse ai/ajo ndërrohet vendbanimin ku është zgjedhur
- c) Nëse këshilltari ia paraqet Kryetarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij
- d) Nëse këshilltari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe i është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj
- e) Nëse këshilltari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës pa arsye
- f) Nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm s'kualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.

44.3 Këshilltari i Kuvendit të Komunës, në të njëjtën kohë, nuk mund të jetë deputet i Kuvendi të Republikës së Kosovës.

Neni 45

Të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës

45.1 Të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës, kanë të drejta dhe mundësi, të barabarta, të marrin pjesë plotësisht, në punimet e Kuvendit.

45.2 Këshilltari i Kuvendit të Komunës, ka të drejtë, të kërkojë informacione, lidhur me çështjet Komunale, nga Kryetari, apo nga Kryesuesi i Kuvendit-Komitetit. Kërkesa shqyrtohet, në pajtim me procedurat, që do të përcaktohen në Rregulloren e punës.

45.3 Këshilltari i Kuvendit të Komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkangjiten procesverbalit.

45.4 Këshilltari i Kuvendit të Komunës, mund t'iu drejtohet të pranishmëve, në cilindo komision të Kuvendit të Komunës, anëtar i të cilit, nuk është, por nuk mund të votojë. Ai, apo ajo, mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit, që të diskutohet, ndonjë çështje, që është përgjegjësi e komitetit.

45.5 Këshilltari i Kuvendit të Komunës, mund të kërkojë, nga Kryetari informacione, që janë të nevojshme, për punën e tij, si këshilltarë. Nëse nuk është i kënaqur, me përgjigjen, ai, apo ajo, mund ta ngritë çështjen, në Kuvendin e Komunës.

45.6 Këshilltari i Kuvendit të Komunës dhe komiteteve, lejohet të mungojë, nga vendi i punës, për periudha kohore, që janë të domosdoshme, për kryerjen e punëve të Kuvendit .

45.7 Këshilltarët e Kuvendit të Komunës, detyrohen të marrin pjesë, në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur, në komisionet, ku ata janë anëtarë, përveç rasteve, kur ekzistojnë arsye, të justifikueshme, për mungesën e tyre.

Neni 46

Funksionimi i Kuvendit të Komunës

46.1 Kuvendi i Komunës funksionon, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

46.2 Kuvendi i Komunës, nuk i delegon përgjegjësitë e tij, lidhur me marrjen e vendimeve për:

- a) Miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e Statutit, Rregullores së Punës, dhe rregulloreve tjera komunale.

- b) Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese
- c) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara, për Kuvendin, sipas Statutit, apo Rregullores së Punës
- d) Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor
- e) Formimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit dhe Statutit
- f) Zgjedhjen e Kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës
- g) Niveli i tarifave dhe ngarkesave
- h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi
- i) Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- j) Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale
- k) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- l) Përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

46.3 Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 47

47.1 Kuvendi i Komunës, zgjedhë Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, nga radhët e këshilltarëve, me shumicën e votave të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

47.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, zgjedhet, për një mandat të njëjtë, sikurse këshilltarët e Kuvendit.

47.3 Votimi për Kryesues të Kuvendit të Komunës, bëhet me vota të fshehta.

47.4 Për t'u zgjedhur, në votimin e parë, kandidati, duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave, të numrit të përgjithshëm, të këshilltarëve të zgjedhur.

47.5 Në raste, në votimin e parë, asnjëri prej kandidatëve, nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numër më të madh të votave, shkojnë në votimin e dytë. Kandidati, që merr më shumë, se gjysmën e votave, të numrit të përgjithshëm, të këshilltarëve, të zgjedhur do të zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

47.6 Procedura e shkarkimit të Kryesuesit të Kuvendit është e njëjtë me atë të zgjedhjes së tij.

Neni 48

48.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

48.2 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve të tij është, së paku gjysma e numrit të këshilltarëve-anëtarëve të Kuvendit-komiteteve.

48.3 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe komitetet e tij, çdo këshilltar-anëtar përfshirë edhe Kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë, nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

48.4 Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorunit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 49

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të thirren edhe nga $\frac{1}{4}$ e këshilltarëve, të Kuvendit të Komunës dhe nga Komitetet e Kuvendit të Komunës, në bazë të rregullave dhe procedurave ligjore.

Neni 50

50.1 Nëse komuna ka më shumë se 10% të qytetarëve, që i takojnë komunitetit joshumicë, rezervon postin e zëvendës kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete.

50.2 Postin e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete e mbanë kandidati përfaqësues i popullatës joshumicë që ka marrë më shumë vota në listat e hapura të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e Komunës.

Neni 51

51.1 Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për komunitete, promovon dialog ndërkomunal dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë në mbledhjet e Kuvendit.

51.2 Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për komunitete, është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e Kuvendit të Komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre.

51.3 Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës për komunitete, aktet apo vendimet e tilla ia paraqet Kuvendit të Komunës për rishqyrtim.

51.4 Në rast se Kuvendi i Komunës nuk e shqyrton aktin apo vendimin, ose Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës, konsideron se rezultati pas shqyrtimit sërish paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai mund ta parashtoj çështjen në Gjykatën Kushtetuese e cila mund të vendosë për pranimin e çështjes për shqyrtim.

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Neni 52

Në mbledhjen e parë, në secilin vit kalendarik Kuvendi i Komunës dhe secili komitet, duhet t'i caktoj datat fikse, në të cilat duhet të mbahen mbledhjet e rregullta gjatë vitit. Datat e mbajtjes së mbledhjeve mund të ndryshohen me vendime pasuese. Mbledhjet tjera mund të thirren në çdo kohë.

Neni 53

Të gjitha mbledhjet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me rregulloren e punës. Personi i cili thërret apo udhëheqë mbledhjet duhet të sigurojë që të gjithë këshilltarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta, dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha veprimet, që janë në kompetencë të Kuvendit.

Neni 54

54.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara, që janë objekt diskutimi, përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

54.2 Kuvendi i Komunës mbanë së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

54.3 Kuvendi i Komunës nëpërmjet Zyrës Përgjegjëse për informim njofton Publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme ndër të tjera me mjetet e mëposhtme:

- a) Shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës
- b) Mediat e shkruara dhe elektronike lokale
- c) Faqen e internetit të Kuvendit të Komunës

54.4 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) Rendin e ditës

54.5 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) Rendin e ditës

54.6 Njoftimi nga paragrafi 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu ti dërgohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 55

Çdo i interesuar nga publiku, i cili merr pjesë në Kuvendin e Komunës dhe komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të mbledhjes, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet Kuvendit - Komitetit. Rregullorja e punës përcakton të drejtat dhe veprimet e udhëheqësit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Neni 56

Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

56.1 Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit.

56.2 E drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për mbledhjen e caktuar.

56.3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

56.4 Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës nuk mbahet nëse të gjithë këshilltarët e Kuvendit dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me Statut dhe Rregulloren e Punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

56.5 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për mbledhjet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

KOMITETET E PËRHERSHME DHE KOMITETET TJERA

Neni 57

57.1 Kuvendi i Komunës formon komitetet e përhershme:

- a) Komitetin për Politikë dhe Financa dhe
- b) Komitetin për Komunitete.

57.2 Në pajtim me nenin 51.2 të LVL, Kuvendi i Komunës formon edhe komitete tjera:

- a) Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
- b) Komitetin për Arsim dhe Kulturë,
- c) Komitetin për Zhvillim Ekonomik,
- d) Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- e) Komiteti për Shërbime Publike Komunale, Mbrojtje dhe Shpëtim.

57.3 Kuvendi i Komunës përpos komiteteve të lartshënuara në paragrafin 2 të këtij neni, mund të formoj edhe komitete tjera.

57.4 Komitetet tjera të nevojshme të parapara me paragrafin 2 të këtij neni, do të kenë nga pesë (5) deri në shtatë (7) anëtarë dhe në përbërjen e tyre shumica e anëtarëve të këtyre komiteteve zgjedhën nga këshilltarët e Kuvendit të Komunës, duke respektuar proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor.

57.5 Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i çdo komiteti të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni zgjedhën nga anëtarët e komitetit përkatës.

57.6 Komitetet në radhët e veta mund të kenë anëtar jashtë kuvendit të komunës, të cilët duhet të kenë përvojë adekuate dhe kritere profesionale varësisht nga komiteti ku emërohet. Emërimi i tyre do të bëhet me propozim të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës duke respektuar proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinorë.

Neni 58

Komiteti për Politikë dhe Financa

58.1 Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet të emërohen nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës. Anëtarësimi duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës.

58.2 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

58.3 Numri i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të jetë nga 5 deri në 9 anëtarë.

58.4 Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës mbledhjet kryesohen nga njëri prej anëtarëve të këtij komiteti.

Neni 59

Komiteti për Komunitete

59.1 Anëtarët e Komitetit për Komunitete emërohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të Komuniteteve pakicë.

59.2 Numri i anëtarëve të Komitetit për Komunitete duhet të jetë nga 5 deri në 9 anëtarë.

59.3 Komiteti për Komunitete në Komunë, përbëhet nga përfaqësuesit (së paku me nga një përfaqësues) të të gjitha komuniteteve pakicë që jetojnë në komunë. Shumica e anëtarëve të këtij Komiteti përbëhet nga komunitetit pakicë.

59.4 Komitetin për Komunitete e kryeson Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete.

INFORMIMI PËR KËSHILLTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 60

60.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga këshilltarët e Kuvendit të Komunës të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, duhet të adresohen me shkrim te zyrtari përgjegjës i Komunës nga i cili kërkohen informatat.

60.2 Zyrtari përgjegjës i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet ti përgjigjet me shkrim këshilltarit ose këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

60.3 Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga zyrtari përgjegjës komunal, i cili duhet ta shënoj datën e kërkesës së marrë dhe datën e përgjigjes së dhënë.

60.4 Në qoftë se zyrtari komunal konsideron, se dhënia e ndonjë përgjigje për kërkesën, apo pyetjen e veçantë është e dëmshme për interesat e përbashkëta të qytetarëve të komunës, ai mund të refuzojë me shkrim duke paraqitur arsyet për dhënien e përgjigjes së tillë.

KOMPENSIMI I KËSHILLTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 61

Kompensimi për punën e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të komiteteve duhet të jetë konform rregullave të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 62

Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë do të caktoj kompensimin për këshilltarët e Kuvendit dhe të komiteteve në pajtim me udhëzimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës

KONFLIKTI I INTERESIT TË KËSHILLTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 63

Këshilltarët e Kuvendit të Komunës nuk mundë të jenë edhe anëtarë të emëruar në Ekzekutivin dhe Administratën e Komunës.

Neni 64

Përfundimet në procesin e vendimmarrjes për shkak të konflikteve të interesit bëhen në bazë të nenit 37 dhe 38 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

Neni 65

Këshilltarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar, nuk duhet të flasin e as të votojnë, për çështjen, për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes, atëherë kur diskutohet ajo çështje.

Neni 66

66.1 Nëse vije deri te ndonjë konflikt potencial i interesit, pasi që është marrë vendimi, por para se të zbatohet vendimi, ai duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

66.2 Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri për marrjen e vendimit.

KAPITULLI VIII

MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE DHE PARTNERITETET

Neni 67

67.1 Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet ti prezantoj rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshjet, të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

67.2 Kuvendi i Komunës vendos për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësive dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

Neni 68

Kryetari i Komunës pas konsultimit me Komitetin për Politikë dhe Financa, duhet t'i prezantoj rekomandimet e tij në Kuvendin e Komunës në lidhje me marrëveshjet, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale për mbikëqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike lokale, që ofrohen më shumë se me një komunë.

Neni 69

Kuvendi i Komunës mund, që brenda kornizës së ligjit, të bëjë marrëveshje, që të bashkëpunojë dhe të formoj partneritete me kuvendet tjera komunale, ashtu që t'i kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

Neni 70

Kuvendi i Komunës mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale, në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

KAPITULLI IX

FINANCAT KOMUNALE DHE PROCEDURAT BUXHETORE

Neni 71

71.1 Komuna ka buxhetin dhe financat, për të ushtruar kompetencat e saj. Buxheti dhe financat e Komunës, përcaktohen me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 dhe aktet tjera.

71.2 Buxheti i Komunës përbëhet prej të hyrave vetanake, granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacioneve dhe të hyrave të tjera.

71.3 Të gjitha çështjet, që janë të lidhura me administrimin financiar të Komunës, janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës.

71.4 Kryetari i Komunës, përgjegjësitë, që kanë të bëjnë me administrimin financiar mund t'i bartë te Nënkryetari i Komunës, apo te ndonjëri prej Drejtorëve të Drejtorive të Komunës.

Neni 72

Shërbimet Komunale që ofrohen nga Ndërmarrjet Publike Komunale

72.1 Në rastet kur shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale, ato ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre Kuvendit të Komunës për miratim. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal.

72.2 Në rast kur një ndërmarrje ofron shërbime publike komunale për më shumë se një komunë, komunat formojnë këshillin (bordin) e përbashkët menaxhues për mbikëqyrje të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Neni 73

Organizatat jofitimprurëse

Komuna e Kamenicës, përkrah aktivitetin e organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse të komuniteteve, aktiviteti i të cilave është në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe përgjegjësi të përgjithshme të komunës. Të gjitha këto organizata i përmbahen ligjit në fuqi kur ofrojnë shërbime dhe kur zhvillojnë aktivitete.

Neni 74

Auditimi i brendshëm

74.1 Komuna ka obligim ligjor të bëjë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.

74.2 Komuna ka të drejtë të formoj një shërbim të pavarur për auditim në Komunë, apo për të siguruar auditim të brendshëm nga një firmë e akredituar e auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 75

Auditimi i jashtëm

75.1 Autoriteti qendror i pavarur bën auditimin e jashtëm të komunës në baza vjetore, në pajtim me ligjin në zbatim të Auditorit gjeneral të Republikës së Kosovës.

75.2 Të gjitha raportet e auditorit dhe përgjigjet e autoriteteve lokale bëhen publike dhe shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

KAPITULLI X

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

KRYETARI I KOMUNËS DHE ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 76

Kryetari i Komunës zgjedhet me mandat katër vjeçar, të njëjtë me këshilltarët e Kuvendit të Komunës.

Neni 77

Kryetari i Komunës është udhëheqës i organit ekzekutiv të komunës dhe zgjedhet drejtpërdrejtë nga qytetarët me të drejtë vote.

Neni 78

Kryetari i Komunës ushtron përgjegjësitë si në vijim:

- a) Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj
- b) Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të komunës
- c) Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij
- d) Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës
- e) Emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj
- f) Emëron dhe shkarkon anëtarët e tij, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave
- g) Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës
- h) Propozon rregullore, apo akte të tjera, për miratim në Kuvendin e Komunës

- i) Propozon strategjinë zhvillimore komunale, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar
- j) Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës
- k) Mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim apo interesin e komuniteteve
- l) Do ta konsultojë Nënkryetarin për komunitete për çështjet, që kanë të bëjnë me komunitetin jo-shumicë dhe
- m) Aktivitetet tjera që i caktohen nga Kuvendi i Komunës.

Neni 79

Përgjegjësitë tjera të Kryetarit të Komunës janë si në vijim:

- a) Mbikëqyr administrimin e përgjithshëm financiar të Komunës
- b) Mbikëqyr zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës
- c) Deleton përgjegjësi të Drejtorët e drejtorive komunale dhe mbikëqyr zbatimin e përgjegjësive të deleguara
- d) I propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e drejtorive dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi
- e) I ofron propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale, si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve tjera publike
- f) Bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të drejtorive sipas nevojës, duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar
- g) Dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës.

Neni 80

Ekzekutivi i Komunës – Kryetari, për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kuvendi i Komunës ndihmohet nga Nënkryetari i Komunës, nënkryetari i Komunës për komunitete dhe Administrata Komunale - Drejtorët komunal.

Neni 81

Raporti vjetor

81.1 Kryetari i Komunës paraqet raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal. Raporti i prezantohet Kuvendit të Komunës për miratim deri me 30 maj të vitit vijues.

81.2 Raporti duhet të përmbaj:

- a) Të hyrat dhe të dalat e planifikuara
- b) Realizimet, synimet e planifikuara me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre
- c) Mënyrën dhe lartësinë e financimit të aktivitetit të caktuar
- d) Gjendjen financiare të Komunës në fund të vitit fiskal
- e) Raportin e kontrollit financiar
- f) Përkrahjen e dhënë organizatave jo fitimprurëse
- g) Marrëveshjet e arritura me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të dhënat tjera të parapara me ligj dhe me akte tjera nga lëmi i financave.

Neni 82

Nënkryetari i Komunës

82.1 Kryetari i Komunës ka një nënkryetar.

82.2 Nënkryetari emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

82.3 Me kërkesë të Kryetarit, Nënkryetari e ndihmon Kryetarin në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

82.4 Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

82.5 Neni 60 për konfliktet e interesit të kryetarit zbatohet *mutatis mutandis* për nënkryetarin.

Neni 83

Nënkryetari i Komunës për Komunitete

83.1 Nëse në kuadër të Komunës ka të paktën 10% të qytetarëve që i përkasin komuniteteve jo-shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete.

83.2 Nënkyetari për Komunitete do të emërohet për mandat të njëjtë si të Kryetarit.

83.3 Emërimi dhe shkarkimi i Nënkyetarit për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve joshumicë.

83.4 Nënkyetari për komunitete do t'i ndihmojë Kryetarit dhe do të ofrojë këshilla dhe udhëzime për Kryetarin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin pakicë.

83.5 Kur posti i Nënkyetarit për komunitete mbetet i lirë, Kryetari propozon Nënkyetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë sipas procedurave të paragrafit 3 të këtij neni.

83.6 Neni 59 i këtij ligji për konfliktet e interesit të Kryetarit zbatohet mutatis mutandis për Nënkyetarin për komunitete.

Neni 84

Drejtoritë Komunale

84.1 Administrata Komunale organizohet në drejtori. Çdo drejtori komunale, menaxhohet nga drejtori. Drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.

84.2 Në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës formon këto drejtori:

- a) Drejtoria e Administratës
- b) Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- c) Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- d) Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit
- e) Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe
- f) Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

84.3 Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës mund të formojë edhe drejtori e zyre tjera sipas nevojës.

84.4 Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorive Komunale do të përshkruhen me rregullore të veçantë.

Neni 85

Konflikti i interesit për drejtorët

85.1 Drejtorët përjashtohen nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai/ajo, apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij/saj ka ndonjë interes personal ose financiar.

85.2 Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi të shfaqen.

85.3 Përjashtimi nga procedurat e vendim marrjes së zyrtarëve të sipër përmendur mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare ose me vendim të shumicës të atij kuorumi ose me kërkesë të palës së tretë nëse personat e përmendur janë drejtpërdrejtë të përfshirë në atë çështje që mund të shkaktoj konflikt interesash.

SHËRBIMI CIVIL I KOMUNËS

Neni 86

Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të komunës, duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 87

Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

Neni 88

Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit, për të siguruar, që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

Neni 89

Shërbimi Civil Komunal, si tërësi, duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me nevoja të veçanta.

Neni 90

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me udhëheqësin e Personelit do të emërojë një nën - komision, detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore, që kanë të bëjnë me shërbimin civil komunal në veçanti me çështjet në vijim:

- a) Kategoritë dhe numrat për kategori
- b) Mbikëqyrja dhe përgjegjësitë

- c) Detyrat dhe obligimet
- d) Delegimi i detyrave dhe obligimeve
- e) Rekrutimi dhe përzgjedhja
- f) Kushtet e pranimit
- g) Fillimi i punës në zyrë, puna provuese
- h) Procedurat ankimore
- i) Procedurat e kundërshtimeve
- j) Trajnimi dhe provimet
- k) Rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit
- l) Përparimi dhe suksesi në karrierë
- m) Dosjet dhe referencat e stafit
- n) Kohëzgjatja e punësimit dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punësimit
- o) Pagesat dhe shpërblimet tjera
- p) Pagesa për udhëtim dhe mëditjet
- q) Pushimi
- r) Rregullat e shërbimit civil komunal

Neni 91

Aktet formale dhe dokumentet zyrtare

91.1. Sipas këtij Statuti:

- a) **“Komuna”** i nënkupton të gjitha definicionet në vijim: Kuvendi i Komunës dhe cilido komitet i tij, Kryetari i Komunës, Kryesues i Kuvendit, Udhëheqësi i Personelit, Drejtorët e Drejtorive dhe çdo zyrtarë, apo organizatë që vepron në emër të organeve të lartpërmendura dhe
- b) **“Akt Formal”** nënkupton vendimin unilateral të marrë nga Komuna, i cili ka efekt juridik ndaj një personi ose më shumë personave apo organizatave.

91.2 Përveç rasteve urgjente, arsyetimet për të gjitha aktet formale duhet t’iu komunikohen me shkrim palëve, në kohën kur është kryer veprimi formal. Në raste urgjente kur praktikohet, arsyet mund të ofrohen edhe gojarisht dhe të komunikohen me shkrim sa më shpejt që është e mundur. Parimet e proporcionalitetit dhe mirëbesimit duhet të qeverisin me ndërmarrjen e të gjitha akteve formale.

91.3. Pala duhet të informohet me shkrim për çdo të drejtë të tij për ankesë dhe për procedurën e shqyrtimit që ekziston në lidhje me veprimet formale. Kjo informatë do të jepet kur akti formal është kryer ose në raste urgjente sa më shpejt që është e mundur.

91.4 Të gjitha kontratat, marrëveshjet dhe dokumentet tjera zyrtare të komunës duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Komunës dhe nga personat e autorizuar që veprojnë në emër të tij.

Neni 92

Informatat

Kryetari i Komunës do të vë në dispozicion të publikut tërë materialin publik, ku përshkruhen detyrat dhe kompetencat e komunës, organizimi i brendshëm dhe mënyra se si publiku mund të shfrytëzoj shërbimet që ju afrohen.

Neni 93

Të gjitha shkresat dhe kumtesat zyrtare që i lëshon komuna do të kenë emrin, titullin, adresën dhe numrin e telefonit të personit që i ka lëshuar dhe që mund të afrojnë informata më të hollësishme lidhur me çështjen në fjalë.

Neni 94

Çdo person mund të ketë qasje në dokumentet e komunës në pajtim me ligjin në fuqi mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 95

Personi që ka qasje në dokumentin zyrtar do të ketë mundësi ta bëjë një kopje të dokumentit për nevojat e tij. Komuna mund ta lëshojë një kopje dhe të kërkoj një tarifë që nuk tejkalon çmimin e kopjes.

Neni 96

Nëse një person dëshmon se dokumentin të cilin e lëshon komuna përmban informata të gabueshme, ai/ajo do të ketë të drejtë të kërkojë që ato informata të përmirësohen falas.

KAPITULLI XI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 97

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave statutare me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitat e Ligjit mbizotërojnë.

Neni 98

Ky Statut hynë në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimin të tij nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Neni 99

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti, pushojnë të vlejnë dispozitat e Statutit nr. 002/2008 i datës 30. 04. 2008.

Neni 100

Me aprovimin e këtij Statuti, të gjitha aktet tjera të Komunës, brenda tre muajve do të harmonizohen me Statutin në fuqi.

Neni 101

Interpretimi autentik i këtij Statuti, bëhet nga Kuvendi i Komunës.

Kuvendi i Komunës – Kamenicë

01. Nr. _____/ 2008

Kamenicë, më 26.09.2008

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bajram Morina _____